

FJALA E DEPUTETIT TONI GOGU

E ENJTE 10 NËNTOR 2022

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë që na ndiqni,

Tërmeti rrënues i vitit 2019, pandemia vrastare e vitit 2020, kriza energjetike e zmadhuar e vitit 2021 dhe lufta mizore, që më në fund po e thoni tashmë nga tavolinat tuaja, sepse më kollaj besoni se toka është e sheshtë, sesa një luftë po bëhet në derën e shtëpisë, kanë nxjerrë në pah karakteristikat më të mira të shqiptarëve: të fortë dhe të palëkundur në fatkeqësi, praktikë dhe pragmatistë në sfida, optimistë, shpresëtarë në të ardhmen, të gatshëm për t'u bërë bashkë dhe për të bashkëpunuar për t'ia dalë mbanë. Ky buxhet është për këta shqiptarë. Për tallësit dhe për përqeshësit kam dy fjalë në fund. Ky buxhet ofron 3 gjëra, që i ka marrë vesh në këtë sallë i madh e i vogël, por i kuptojnë edhe të gjithë ata që po na ndjekin; ka vetëm një pjesë shumë të vogël që nuk duan ta kuptojnë dhe do ta them në fund pse. Gjëja e parë që ofron ky buxhet, është mburoja, mbrojtja e përgjegjshme, jo aventureske, siç thuhet këtu: “Ngrije aq, e bëje aq, hidhi këtu e hidhi atje”; mbrojtja e përgjegjshme e ekonomisë familjare shqiptare.

E dyta, shenjëstrohet investimi për një ekonomi më moderne, një ekonomi më konkurruese, një ekonomi më të qëndrueshme.

E treta, ç'prangoset kjo ekonomi nga një borxh që na e keni lënë dhe jeni bërë kaq familjar me të, sa u duket sikur ta keni kafshë shtëpiake; ju duket sikur e keni zbutur dhe e keni pas vetes, e doni gjithë kohës. “Bëjeni borxh!” thoni, madje i keni bindur edhe sipërmarrësit tuaj të thonë: “Po, zgjidhet me borxh publik”. Çfarë janë këto “PPP-të me borxh publik”?

Për t'i marrë me radhë dhe për të thënë që mbrojtja më e mirë nga ajo luftë, të cilën më në fund e mësuat, se ka trokitur në tryezën e çdo shqiptari, është menaxhimi i përgjegjshëm, i arsyeshëm dhe i qëndrueshëm këtu në shtëpinë tonë. Këtë gjë bën ky buxhet; këtë ofron ky buxhet.

Po them dy fjalë për parashikimin ekonomik, sepse ju më kollaj jeni duke parashikuar 12-vjetorin sesa parashikimin ekonomik, që ka nevojë ta dëgjojë sot çdo shqiptar. Ekonomia botërore po lëkundet nga një pandemi, që është ende vërdallë, nga një luftë që s'po mbaron, nga një krizë energjetike që vetëm zmadhohet, ndërkohë që kemi disa lajme të mira. Më lini t'ju them lajmet e mira, në fakt, e kam për qytetarët, sepse tallësit dhe përqeshësit nuk dëgjojnë asnjëherë. Në vitin 2023 përmes këtij buxheti dhe përmes të gjithë atyre tipareve, karakteristikave të shqiptarëve që ky buxhet nxit, rritja ekonomike e vendit do të jetë 2,3%. Ndërkohë që inflacioni do të bjerë në 3,6%. Hidhini sytë vërdallë dhe shikoni që nuk janë këto shifra; nuk është kjo zhdërvjelltësi ekonomike nga fqinjët e afërt dhe deri më larg.

Më lini vetëm pak t'ju kujtoj edhe njëherë, por më shumë për qytetarët, planin 5 pikësh të qeverisë që bën mburojën për ekonominë shtëpiake të çdo familjeje shqiptare.

Mburoja energjetike

Vetëm në vitin 2021 janë dhënë 50 miliardë lekë për mburojën energjetike. Ore, paguani drita ju, apo jua paguajnë hyzmeqarët? Këtu dolën disa kolegë njëri pas tjetrit që treguan një faturë, më falni që po flas me të vjetra, 40 mijë lekëshe. Për çdo pensionist, për çdo prind, për çdo nënë, për çdo baba që shkon dhe paguan faturën e dritave 40 mijë lekë shteti, kjo qeveri ka paguar me parë 140 mijë lekë, madje edhe pak më shumë. Ju thoni pse nuk shtohet ky pension. Ja, pra, ku është ky pension! Është një pension i tërë që është shtuar dhe paguhet energjia. Por nëse ju nuk e kuptoni se çmimi i energjisë do të kishte qenë atje ku ju doni ta lini, familjet shqiptare do të kishin falimentuar, sepse nuk do të blinin dot bukë, ushqime, vaj, oriz, miell, por, kur nuk e kupton dot ekonominë dhe e bën me disa shifra të dala boje, patjetër! Pra, mbrojtja energjetike ishte pjesë e planit të qeverisë.

E dyta, është rritja e pagave dhe e pensioneve: "Pse nuk i dyfishoni pagat dhe pensionet?". Po, pikërisht pra, janë dyfishuar pagat dhe pensionet. Buxheti kur thuhet është dyfish, është dyfish i buxhetit që latë ju. Paga juaj minimale ka qenë 19 mijë lekë, sot është 36 mijë lekë, është dyfishuar. Po të shikoni tavanin e patatueshmërisë nga 40 mijë lekë në 50 mijë lekë, që ju e gërryeni me atë taksën 10%, të cilën ia merrni të varfrit, është dyfishuar. Kështu që mos gënjeni njerëzit!

E treta, fuqizimi i ndihmës ekonomike. Po ku kishit menduar ndonjëherë ju për gratë me shumë fëmijë, ku kishit menduar ndonjëherë ju për nënat sipërmarrëse, ku kishit menduar ndonjëherë ju...

E di, e di që ju vret veshët, sepse ende jeni akoma tek ato gra dhe ato nëna që i merrni nga politika e i çoni në botën e medias, nga bota e medias i çoni në politikë e kështu me radhë. Megjithatë, ne do ta vazhdojmë misionin tonë, është misioni ynë.

E katërta, është kreditimi i butë i strehimit për çdo familje shqiptare. Garancia sovrane e vendosur në buxhet është jo pak, por është për 1000 familje, të cilat mundet të shkojnë të hyjnë në shtëpi të reja, gjëra të cilat as nuk mendoheshin në kohën tuaj.

E fundit fare, më shumë ilaçe falas, nuk do të flas për këtë, sepse ministrja ka folur gjerë e gjatë.

Mburojë energjetike, paga dhe pensione më të larta, ndihmë ekonomike, ilaçe falas, pra ky është plan i qartë 5 pikësh. Ajo çfarë erdhi mbrapsht ishin akuza, akuza, akuza dhe gënjeshtër.

Do të ndërtohet një ekonomi më e zhdërvjellët, moderne, e rinovueshme. Zëvendëskryeministrja, njëkohësisht ministre e Energjetikës dhe Infrastrukturës foli qartë, të gjithë kolegët folën qartë për sektorët strategjikë: 3% në arsim, 3% në shëndetësi dhe 14 miliardë në bujqësi.

Është ulur borxhi, pra 700-milionëshi që ju kishit fshehur. Nëse sot gjeni një vend tjetër, i cili në buxhetin për vitin 2023 ul borxhin, hajdeni këtu, nxirreni dhe i pari jam unë që tërhiqem nga kjo foltore, pra një vend që ul borxhin, ndërsa mbron familjen, ndërsa nxit ekonominë, sepse që të ulësh borxhin, duhet ta shprangosësh ekonominë nga prangat që i keni vendosur.

Në fund fare dua të them këto gjëra:

Të nderuar qytetarë, ju keni dëgjuar dy histori, por ka vetëm një buxhet një të përgatitur nga kjo shumicë socialiste, sepse identiteti nxjerr të vërtetën. E kanë provuar dy herë karrigen e shenjtë të administratorit publik. Në vitin '97, kur i morën shqiptarët dhe i përzhelitën, i nxorën jashtë, sepse u morën çdo gjë shqiptarëve. Në vitin 2013 përsëri shqiptarët ju thanë: "Jeni të padenjë për të na i administruar publikisht të ardhurat". Madje, kësaj radhe nuk mjaftuan vetëm shqiptarët, por edhe partnerët tanë thanë: "Të padëshirueshëm për ne, keni futur duart në financat publike". Të jesh i korruptuar dhe të jesh non grata, do të thotë që i ke futur duart në financat publike. Kështu që mos u merrni me gjëra, me të cilat keni dështuar me turp dhe ai që dështon, pastaj fajëson.

Ju ftoj ta votojmë, sepse është e vetmja gjë që ju mund të bëni. Faleminderit!